

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7193  
E enjte, 23 maj 2024  
Çmimi 0.50 €

## Cameroni: Procesi i pajtimit dhe rritjes ekonomike, përparësi në Ballkan



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# 25 VJET NGA MASAKRA NË BURGUN E DUBRAVËS, KËRKOHET PËRGJEGJËSI NGA SERBIA PËR KRIMIN GJENOCIDAL



25 vjet më parë, prej 19-24 maj 1999, pushteti gjenocidal i Serbisë i vrau brenda burgut të Dubravës rreth 120 të burgosur shqiptarë të luftës dhe të burgosur politikë dhe i plagosi 300 të tjerë. Kjo masakër

shpërfaqti, sikur edhe në shumë masakra të tjera gjithandej Kosovës, egërsinë e pushtetit kriminal kundrejt të burgosurve shqiptarë të luftës dhe të burgosurve politikë, të cilët padrejtësisht mbaheshin

në burg. Kështu u tha me rastin e këtij përvjetori të mërkurën në ambientet e burgut të Dubravës nga përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe nga të mbijetuarit e kësaj masakre

## PROCESI I BERLINIT KONSIDEROHET PLATFORMA MË E MIRË PËR ZHVILLIM EKONOMIK, BE-së I KËRKOHET HEQJA E MASAVE



## AAK-ja AKUZON QEVERINË KURTI SE NUK KA PUNUAR PËR LEHTËSIMIN E VOTIMIT NGA DIASPORA

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçishtë - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) / [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



## FRANCA KRITIKON KOSOVËN PËR AKSIONIN POLICOR NË VERI

## FILLOI DEZINSEKTIMI I ZONAVE ENDEMIKE NË MALISHEVË KUNDËR RRIQRAVE

## ANKETA E IDM-SË: TETË NË DHJETË SHOIPTARË BESOJNË SE KORRUPSIONI I VOGËL DHE I MADH JANË TË PËRHAPUR

### EKONOMI



## ÇFARË DO TË BËHET ME PARATË E MARRA NGA INSTITUCIONET SERBE NË VERI?

### SPORT



## SONTË VENDOSËT KAMPIONI I RI NË SUPERLIGË



## Cameroni: Procesi i pajtimit dhe rritjes ekonomike, përparësi në Ballkan

TIRANË, 22 MAJ - Sekretari i Jashtëm i Britanisë së Madhe, David Cameron, ka deklaruar gjatë vizitës në Tiranë, se Mbretëria e Bashkuar do të jetë më e pranishme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. "Nëse Ballkani Perëndimor ia del mbanë, atëherë Evropa ia del mbanë. Në rast se ka probleme në Ballkanin Perëndimor, atëherë ka probleme edhe në Evropë sepse, në fakt, është në interesin tonë të përbashkët të ndihmojmë në procesin e pajtimit, rritjes ekonomike dhe të mirëkuptimit dhe për mua kjo është përparësi", tha Cameroni.

Në deklaratën e përbashkët për media me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, zyrtari britanik foli të mërkurën për projekte të rëndësishme mes të cilave edhe për financimin e hekurudhës Durrës - Prishtinë. "Kemi projekte shumë emocionuese si, për shembull, hekurudhën që ju shpjeguat, nga Prishtina në Durrës, që do të jetë shumë e rëndësishme jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Kosovën dhe për të gjithë rajonin", tha kryediplomati britanik.

Projekti për linjën hekurudhore Durrës - Prishtinë ishte paraqitur në qershor të vitit 2022 gjatë mbledhjes së përbashkët të Qeverisë së Shqipërisë dhe të Kosovës që u mbajt në Prishtinë. Realizmi i linjës hekurudhore Durrës - Prishtinë do ta

mundësonte nisjen e projektit tjetër, që është ndërtimi i dy porteve të reja tregtare: Porto Romano në Durrës dhe Porti i Thatë në Prishtinë.

Ndërkaq kryeministri Rama tha se vizita e Cameronit do t'i shërbejë jo vetëm thellimit të marrëdhënieve dypalëshe, por edhe shtimit të pranisë së Mbretërisë së Bashkuar në rajon. "Mbretëria e Bashkuar synon të jetë më e pranishme në rajonin tonë dhe dëshiroj të theksoj se kemi folur për përfshirjen e Mbretërisë së Bashkuar në një projekt strategjik me një rëndësi të veçantë për Shqipërinë, për Kosovën, por edhe për rajonin që është hekurudha Durrës - Prishtinë. Kjo hekurudhë është një element kyç i projektit të rritjes së kapaciteteve të lëvizjes, jo vetëm mes dy vendeve tona, por në rajon dhe më gjerë, duke pasur parasysh që së shpejti ne hapim garën ndërkombëtare për Portin e Ri Tregtar të Durrësit. Jemi në pritje të përgjigjes përfundimtare të NATO-s për krahun ushtarak të portit të Durrësit dhe, njëkohësisht, siç jeni të informuar, edhe Kosova do të ndërtojë një Port të Thatë në Prishtinë", tha Rama.

Ai, gjithashtu, theksoi se kanë diskutuar edhe për ecurinë e proceseve të pajtimit dhe të bashkëpunimit në rajon. Rama tha se Mbretëria e Bashkuar ka shprehur vazhdimisht interes të veçantë për ta parë normalizimin e plotë të




marrëdhënieve rajonale dhe për ta parë përfundimin me sukses edhe të procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas kryeministrit të Shqipërisë, në këtë proces ka pasur hapa pozitive, po ka edhe ngecje në vend apo, siç ka thënë ai, "në vijimësi ndihet edhe rreziku i kthimit prapa". Cameroni dhe Rama diskutuan edhe për projektin e përbashkët të luftës kundër trafikut të paligjshëm të qenieve njerëzore dhe rezultateve të arritura. Ata thanë se ky operacion do të vazhdojë dhe gatishmëria për dekurajimin e flukseve të këtij trafikut do të jetë maksimale. Sipas Ambasadës Britanike në Tiranë, lidhjet tregtare janë

dyfishuar vitin e kaluar dhe turistët e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri janë rritur për 30 për qind në janar 2024, krahasuar me janarin e vitit 2023, duke u hapur rrugë parashikimeve për një turizëm në nivele rekord këtë vit. Cameron u prit në Aeroportin e Rinasit nga ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Igli Hasani. Gjatë vizitës ishte paraparë edhe një takim në mes të kryediplomatit britanik dhe presidentin shqiptar Bajram Begaj. Por, takimi me Begajn, sipas Presidencës shqiptare, u anulua për shkak të agjendës së ngjeshur të Cameronit. Gjatë vitit 2022 mbi 45 mijë njerëz e kaluan Kanalin Anglez

për të mbërritur në Britani të Madhe. Ministria e Mbrojtjes e Britanisë veçoi imigrantët shqiptarë, iranianë dhe ata afganë në këtë shifër rekorde. Gjithashtu, sekretari i Jashtëm britanik njoftoi për një program të ri që lidhet me gjyqësorin, për t'i trajtuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në Shqipëri, si dhe ofrimin e ekspertizës së Mbretërisë së Bashkuar për Policinë Shqiptare. Mbretëria e Bashkuar ka ofruar 4 miliardë paundë për projekte në Shqipëri, që do të realizohen në bashkëpunim me Ministrinë e Financës, Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës dhe bashkë në të gjithë vendin.

## Ukraina e zbraps një valë të re sulmesh ajrore ruse



KIEV, 22 MAJ - Kundërajrorët ukrainas i rrëzuan të gjithë 24 dronët me të cilët Rusia e sulmoi Ukrainën mëngjesin e së mërkurës, thanë Forcat Ajrore të Ukrainës në një komunikatë. Dronët u shkatërruan mbi rajonet Mikolaiv, Dnipropetrovsk, Zaporizhja, Donjeck, Sumi dhe Odesa, thuhet në komunikatë.

Ndërkohë, këshilli i qytetit Sumi tha se linjat e rrymës dhe tubacionet e ujit u dëmtuan nga mbetjet e dronëve të rrëzuar dhe se kishte ndërprerje të furnizimit me rrymë në qytet. Ai tha se ka nisur puna për kthimin e furnizimit me ujë dhe rrymë për banorët. Këtë pranverë Rusia i ka rritur

sulmet me dronë dhe raketa nëpër Ukrainë, duke i shkatërruar dëme të mëdha infrastrukturës së saj energjetike. Forcat ukrainase i rrëzuan të gjithë 90 dronët e llojit Shahed që Rusia i lëshoi në javën e fundit, tha më 20 maj zëdhënësi i ushtrisë ukrainase Dmytro Lykhoviy.

## Spanja, Irlanda dhe Norvegjia vendosin ta njohin Palestinën si shtet

MADRID, 22 MAJ - Spanja, Irlanda dhe Norvegjia kanë njoftuar të mërkurën se kanë vendosur ta njohin Palestinën si shtet të pavarur, duke argumentuar se zgjidhja me dy shtetet është zgjidhja e vetme për paqe afatgjatë në konfliktin izraelit-palestinez. Kryeministri i Irlandës, Simon Harris, tha se ky ishte një vendim i përbashkët në

mes të vendit të tij, Spanjës dhe Norvegjisë. Ky vendim historik nxiti kundërshtim të ashpër nga Izraeli dhe gëzim në mesin e palestinezëve. Izraeli i tërhoqi menjëherë ambasadorët e vet nga Norvegjia, Irlanda dhe Spanja dhe tha se do t'i ftojë për qortim ambasadorët e këtyre vendeve në Izrael, ku ata do ta shikojnë një video të

sulmit të Hamasit - grupit të shpallur terrorist nga ShBA-ja dhe BE-ja në jug të Izraelit më 7 tetor. Këto tri vende njoftuan njëra pas tjetres përmes konferencave për medie për vendimin e tyre për Palestinën. Para këtij njoftimi, rreth 143 prej 193 vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e njihnin Palestinën si shtet.





# Procesi i Berlinit konsiderohet platforma më e mirë për zhvillim ekonomik, BE-së i kërkohet heqja e masave

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 MAJ - Komisioni për Integrim Evropian në bashkëpunim me GIZ-in kanë organizuar tryezën me temën "Rritja e integritit rajonal: roli i Kosovës në Procesin e Berlinit dhe në kryesimin e CEFTA-s". Aty është thënë se Procesi i Berlinit është një ndër platformat më të mira për të pasur zhvillim ekonomik, ndërsa për Kosovën konsiderohet të jetë ndër

shtetet më profesionale në përmbushjen e obligimeve që kanë dalë krahasuar me vendet e tjera të CEFTA-s.

Kryetarja e Komisionit për Integrim Evropian, Rrezarta Krasniqi, ka thënë se Kosova është e përkushtuar t'i zbatojë reformat në mënyrë që të përfitojë shteti e rajoni. Me këtë rast, ajo ka kërkuar nga Bashkimi Evropian (BE) t'i heqë masat e vendosura ndaj Kosovës. "Si kryetare e komisionit kam pasur privilegjin të dëshmoj hapat e

rëndësishëm që ka bërë Kosova drejt integritimeve evropiane. Procesi i Berlinit i nisur në vitin 2014 përfaqëson një platformë të rëndësishme për nxitjen e zhvillimit ekonomik. Kosova ka qenë pjesëmarrëse aktive në procesin e Berlinit dhe ne mbesim të përkushtuar për promovimin e rritjes ekonomike. Përfshirja e Kosovës tregon gatishmërinë tonë për të punuar me fqinjët tanë. Kosova në vitin 2025 ka nderin ta marrë kryesimin e marrëveshjes së CEFTA-s.

Kosova do të jetë e përkushtuar në rritjen e lehtësimit të tregtisë dhe nxitjen e një tregu më konkurrues dhe më të integruar. Ne jemi të fokusuar në zbatimin e reformave që jo vetëm do të përfitojë ekonomia jonë, por edhe do të kontribuojë në prosperitetin e rajonit. I bëj thirrje BE-së të hiqen masat ndaj Kosovës sepse Kosova është vend evropian dhe asaj duhet t'i hapet rruga drejt Bashkimit Evropian bashkë me vlerat demokratike të saj", është

shprehur Krasniqi.

Ndërsa zëvendës drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kosovare për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve, Zef Dedaj, ka thënë se Kosova tashmë ka dizajnuar politikat e nevojshme të cilat janë në harmoni me ato të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se Kosova do t'i zbatojë të gjitha obligimet në mënyrë profesionale, teksa ka shtuar se vendi është duke performuar shumë mirë krahasuar me shtetet e rajonit.



## Franca kritikon Kosovën për aksionin policor në veri



Prishtinë, 22 maj - Franca është e shqetësuar nga operacionet e fundit të Policisë së Kosovës që çuan në mbylljen e zyrave të bankave postare serbe në veri të Kosovës. Kështu thuhet në një njoftim të Ministrisë së Jashtme të Francës, ndërsa paralajmëron se veprime të reja të njëanshme, kontribuojnë në përshkallëzim të tensioneve. "Këto veprime të reja të njëanshme kontribuojnë në përshkallëzim të tensioneve dhe rrezikojnë diskutimet e vazhdueshme, në kujdesin e Bashkimit Evropian, që synojnë gjetjen e një zgjidhjeje të përkohshme për personat e prekur nga zbatimi i rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës. Ato ndikojnë në jetën e

përditshme të komunitetit serb në Kosovë dhe shkojnë kundër përpjekjeve për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, parakusht për realizimin e perspektivës evropiane të dy vendeve. Franca u bën thirrje autoriteteve të Kosovës të përmbahen nga çdo veprim i mëtejshëm i njëanshëm. Ai inkurajon të dyja palët që të kthehen në tryezën e negociatave dhe të punojnë në propozimin e fundit të kompromisit të paraqitur nga ndërmjetësimi evropian, e vetmja bazë realiste për arritjen e një marrëveshjeje që lejon përfituesit e kualifikuar të marrin transaksione financiare nga Serbia", thuhet në njoftimin e kësaj ministrie.

## Zyrtarët e PDK-së takojnë grupin e këshilltarëve të Bundestagut gjerman, flasin edhe për zgjedhjet e parakohshme

PRISHTINË, 22 MAJ - Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, së bashku me nënkryetarin e Kuvendit, Enver Hoxhaj dhe deputeten Eliza Hoxha, kanë takuar grupin e këshilltarëve të Bundestagut gjerman, me të

cilët kanë diskutuar lidhur me situatën e përgjithshme politike në Kosovë. "Po ashtu, ne i njoftuam edhe me qëndrimet tona si grup parlamentar për rëndësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare,

përmes të cilave synojmë që vendit t'i japim qeverinë e re të perspektivës euroatlantike dhe zhvillimit ekonomik me kryeministrin e ardhshëm, Bedri Hamzën", ka shkruar Tahiri në "Facebook".







# 25 vjet nga masakra në burgun e Dubravës, kërkohet përgjegjësi nga Serbia për krimin gjenocidal

25 vjet më parë, prej 19-24 maj 1999, pushteti gjenocidal i Serbisë i vrau brenda burgut të Dubravës rreth 120 të burgosur shqiptarë të luftës dhe të burgosur politikë dhe i plagosi 300 të tjerë. Kjo masakër shpërfaq, sikur edhe në shumë masakra të tjera gjithandej Kosovës, egërsinë e pushtetit kriminal kundrejt të burgosurve shqiptarë të luftës dhe të burgosurve politikë, të cilët padrejtësisht mbaheshin në burg. Kështu u tha me rastin e këtij përvjetori të mërkurën në ambientet e burgut të Dubravës nga përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe nga të mbijetuarit e kësaj masakre

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**ISTOG, 22 MAJ** - Të mërkurën është shënuar 25-vjetori i masakrës në burgun e Dubravës. Në pranverën e majit, nga 19 deri më 24 maj të vitit 1999, u vranë e u masakruan rreth 120 të burgosur, nga 980 sa ishin grumbulluar në burgun e Dubravës dhe rreth 300 mbetën të plagosur nga forcat serbe. Në këtë përvjetor mori pjesë edhe kryeministri Albin Kurti, ministra, deputetë dhe përfaqësues të pushtetit lokal, të Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, veprimtarë, ish-të burgosur politikë, familjarë të të vranëve, dëshmorëve dhe të mbijetuarve të masakrës së Dubravës. Kurti ka thënë se secili prej të

burgosurve shqiptarë që ishin në burgun e Dubravës në ato ditë të majit të vitit 1999 është dëshmitar i historisë dhe dëshmitar i së vërtetës së Kosovës, teksa theksoi se emrat e skalitur në memorialin e 116 të vranëve në këtë masakër, janë e vërteta dhe akuza më e fuqishme për masakrën e Dubravës. Kryeministri Kurti ka theksuar se i zhdukuri në këtë masakër është edhe politikani dhe ideologu politik i çështjes sonë kombëtare, profesor Ukshin Hoti. “Është e vërteta e mijëra të zhdukurve me dhunë nga Serbia, prej të cilëve 1 597 janë ende të pagjetur. Shteti ynë, Republika e Kosovës, do të gjejë rrugë dhe mënyra, për të dëshmuar sërish e përsëri, sikur sot, sikur vitin e kaluar, sikur që e

kemi bërë gjatë këtyre 25 viteve, për të vënë drejtësi dhe për të vërtetën aq të rëndësishme të historisë, të sakrificës dhe të qëndrësës së popullit tonë”, ka thënë kryeministri. Ndër të tjera, ai përmendi edhe tri gjeneratat që përfshijnë të burgosurit politikë përgjatë tri dekadave, gjatë viteve '50, '60 e të viteve '70; gjenerata e dytë, e quajtur edhe Brezi '81, që përfshin të burgosurit politikë pas demonstratave studentore të vitit 1981, si dhe gjenerata e tretë e viteve '90, duke përfshirë edhe të burgosurit gjatë luftës. “Këtu bëj pjesë dhe vetë unë, që bashkë me shumë prej jush që jeni sot këtu dhe me shumë të tjerë, u arrestova, u burgosa dhe u mbajta peng luftime, ndërkohë që edhe u gjykova në Nish në një proces politik nga autoritetet e regjimit kriminal të Serbisë”, shtoi kryeministri Kurti. Ai ka shtuar se gjatë këtyre 25 viteve historinë dhe skenarët e masakrës së Dubravës “i kemi lexuar në libra, i kemi dëgjuar nëpër intervista dhe në biseda private, nga qindra të burgosur që shpëtuan. I kemi lexuar dhe dëgjuar nga Asllan Selimi, nga Enver Dugolli, nga grupi i Gjakovës me 143 të burgosur, nga Nait Hasani e nga Selim Lokaj, nga Liburn Aliu e nga Bajrush Xhemajli, nga Hajredin Hyseni, nga Raif Qela, Bislim Zogaj, Gjergj Karaqi, Isak

Shabani, Riza Mehmeti, Naser Shportari, Istref Hasani, nga Avni Klinaku, nga Avdi Mehmeti, nga i mbijetuari Rasim Selmanaj, nga Avdyl Jetishi, Frashër Shabani, Blerim Camaj, Sadik Zeqiri, Filip Pjetri, nga Besim Zymberi, Ismet Mahmuti, Enver Berisha, Demë Batusha, Shaban Beka, nga Bilbil Duraku dhe shumë e shumë të mbijetuar të tjerë. Të gjithë këta të mbijetuar me dëshmitë e tyre janë dëshmitarë potencialë në një proces gjyqësor të drejtë dhe të domosdoshëm, me dëshmi dhe aktakuza të provuara ndaj urdhërdhënësve dhe urdhërkryerësve të masakrës së Dubravës”, ka deklaruar Kurti, duke shtuar se të përfshirë kundër vullnetit të tyre politik nën Serbi dhe nën Jugosllavi, shqiptarët e Kosovës ishin komuniteti etnik më i shtypur politikisht, më i shfrytëzuar ekonomikisht, më i diskriminuar dhe më i nënpërfaqësuar në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. “Në rrugën e gjatë tonën gjatë asaj periudhe gjysmëshekullore deri më 1999, të mbushur me aq shumë aktivistë politikë dhe organizata ilegale, me demonstrata dhe beteja, ne shqiptarët e Kosovës kemi pasur tri gjenerata të tëra të burgosurve politikë”, ka thënë Kurti. Ai ka shtuar se sot, teksa e

përkujtojmë masakrën e Dubravës në 25-vjetorin e saj, mijëra të burgosur politikë u morën peng si rob luftime nga Serbia e Millosheviqit, bashkëpunëtorët pasardhës dhe trashëgimtarët politikë të së cilës, në Beograd i vazhdojnë politikat antishqiptare dhe anti-Kosovë, kundër fqinjësisë së mirë dhe paqes në rajon. “Për masakrën e Dubravës kemi dëgjuar së pari në burgun e Lipjanit, ku kam qëndruar nga 2 maji deri më 10 qershor 1999, bashkë edhe me të mbijetuar të kësaj masakre. Pastaj kemi dëgjuar rrëfime edhe në burgun e Pozharevcit dhe të Nishit nga të tjerë të dëshmitarë, gjatë vitit 1999 e deri më 2001. Shteti ynë, Republika e Kosovës, do të gjejë rrugë dhe mënyra për të dëshmuar sërish e përsëri, sikur sot, sikur vitin e kaluar, sikur që e kemi bërë gjatë këtyre 25 viteve, për të vënë drejtësi dhe për të vërtetën aq të rëndësishme të historisë, të sakrificës dhe të qëndrësës së popullit tonë. Sot e n'mot, për çdo mot, sa të jemi gjallë dhe ndër breza përgjithmonë!”, ka thënë Kurti. Në “Facebook” edhe presidentja Vjosa Osmani ka kujtuar masakrën e burgut të Dubravës. “25 vjet më parë, prej 19-24 maj 1999, pushteti gjenocidal i Serbisë i vrau brenda burgut të Dubravës 120 të burgosur shqiptarë të luftës dhe të



burgosur politikë dhe i plagosi 300 të tjerë. Kjo masakër shpërfaqti sikur edhe në shumë masakra të tjera gjithandej Kosovës, egërsinë e pushtetit kriminal kundrejt të burgosurve shqiptarë të luftës dhe të burgosurve politikë, të cilët padrejtësisht mbaheshin në burg. Sot bashkëndiejmë me të gjitha familjet që humbën anëtarët e tyre në këtë masakër, ndërkaq të mbijetuarit i inkurajojmë të vazhdojnë ta mbrojnë të vërtetën dhe të luftojnë për drejtësi. Drejtësi për viktimat dhe kujtim i përhershëm për to!", ka shkruar presidentja Osmani.

Masakrën e burgut të Dubravës e ka përkujtuar edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi. Ai ka thënë se ky përvjetor është shembulli që tregon se deri në çfarë niveli çnjerëzor shteti serb i Milloshëviqit zbatoi planin gjenocidal të spastrimit etnik në Kosovë. "Rrëfimet e të mbijetuarve të kësaj masakre janë dëshmi e gjallë të një krimi që nuk guxon të harrohet asnjëherë. Sot, duke nderuar kujtimin për të gjitha viktimat e kësaj masakre, kërkojmë drejtësinë e munguar për ta dhe familjet e tyre", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



## Anketa e IDM-së: Tetë në dhjetë shqiptarë besojnë se korrupsioni i vogël dhe i madh janë të përhapur



**TIRANË, 22 MAJ** - Anketa vjetore e opinionit publik "Besimi në Qeverisje 2023", zhvilluar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në të 61 bashkitë e Shqipërisë, zbuloi se shumica e pjesëmarrësve (81.5 %) e vlerësojnë korrupsionin e

madh si "të përhapur" ose "shumë të përhapur", duke shënuar një rritje me 4.8 pikë në krahasim me vitin 2022. Vetëm 15.6 % e qytetarëve e shohin atë "jo të përhapur" ose "aspak të përhapur". Rritje ka shënuar edhe

mosbesimi ndaj prokurorisë. Një pjesë e madhe e të anketuarve (62.8 %) nuk besojnë tek aftësia e prokurorisë për t'i trajtuar rastet e korrupsionit të madh, ose shprehin 5.9 për qind më shumë mosbesim nga një vit

më parë, kur ky tregues ishte 56.9 %. Një shumicë po aq e madhe (81.3 %) e tyre vlerësojnë korrupsionin e vogël si "të përhapur" ose "shumë të përhapur". Vetëm 16.2 % që e konsiderojnë atë "jo të

përhapur" ose "aspak të përhapur". Ndërsa 56.8 % e tyre shprehën mungesë besimi tek prokuroria, se ajo mund të ndjekë në mënyrë të efektshme rastet e korrupsionit të vogël. Gjithsesi besimi është rritur me 9 % nga viti 2022, kur mosbesimi ishte 65.8 %. Nga bashkimi i të dhënave doli që tetë në dhjetë shqiptarë besojnë se korrupsioni i vogël dhe i madh është i përhapur dhe shumë i përhapur në vend. Sipas tyre, institucionet më të korruptuara në vitin 2023 janë drejtësia (17.5 %), shëndetësia (14.8 %) dhe policia (7.2 %). Besjana Kuçi, një nga autoret e studimit, thotë për "Zërin e Amerikës" se vazhdon tendenca disavjeçare e perceptimit shumë të lartë nga publiku mbi përhapjen e korrupsionit, dhe se për t'i kuptuar shkaqet e këtyre treguesve, duhen studiuar shumë zhvillime sociale e politike në vend. "Ne si shoqëri e kemi përforcuar në nivele të ndryshme dukurinë e korrupsionit në raport me institucionet. Mesatarja ndër vite është mbi 77 për qind e të anketuarve. Zhvillimet politike nuk kanë ndikuar pozitivisht për ta mbajtur larg këtë dukuri nga proceset qeverisëse në vend", thotë Kuçi.



## Rama premton linja të reja dhe autobusë të rinj për qytetarët

PRISHTINË, 22 MAJ - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se kanë filluar reformimin e sistemit të transportit publik. Sipas tij, kjo reformë do të sjellë flotë të re të autobusëve nga 1 janari 2025. "Më shumë linja të autobusëve sipas nevojave të qytetarëve, mbulim i më

shumë rrugëve me transport publik, një biletë për të gjitha linjat në kryeqytet, pra biletë e integruar dhe sisteme digjitale të pagesës së biletave", ka thënë ai. Ai ka thënë se çdo hap i kësaj reforme është bërë në bashkëpunim të ngushtë dhe në konsultim me operatorët privatë të linjave të

autobusëve, Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, përfaqësuesit e bankave në Kosovë dhe të tjerë. "Kjo reformë do ta përfshijë garantimin e kredive për blerjen e autobusëve privatë dhe, rrjedhimisht, dhënien e linjave të reja për këta operatorë privatë", është shprehur kryetari Rama.



## Konjufca priti në takim Komitetin Parlamentar Arabi Saudite - Kosovë, diskutohet për thellimin e bashkëpunimit



PRISHTINË, 22 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës priti të mërkurën në takim Komitetin Parlamentar Arabi Saudite - Kosovë, i cili po qëndron për vizitë në vendin tonë. Duke i falënderuar përfaqësuesit e komitetit nga Arabia Saudite, kryetari Konjufca tha se raportet e mira mes dy vendeve tona duhet të jenë pikënisja nga ku gjejmë mënyrat më të mira të zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit, në secilën fushë që e kërkon interesi i përbashkët.

Përfaqësuesit e Komitetit Parlamentar Arabi Saudite - Kosovë theksuan gatishmërinë e Arabisë Saudite për intensifikimin e raporteve mes vendeve tona në të gjitha fushat e nevojshme. Palët u pajtuan se ky takim i kontribuon qëllimit të dyanshëm për angazhim sa më të gjerë në drejtim të interesave të përbashkët. Nga delegacioni arab e falënderuan kryetarin Konjufca për mikpritjen dhe diskutimin për çështje me interes për vendet tona.

## Policia po realizon fushatën me moton "Trafiku rrugor nuk është i destinuar për gara shpejtësie"

MITROVICË, 22 MAJ - Drejtorja Rajonale e Policisë në Mitrovicë e Jugut është duke realizuar fushatë vetëdijesimi për drejtuesit e mjeteve, referuar Ligjit të ri për Rregullat e Trafikut Rrugor, dispozitat e të cilit parashohin gjoba për shoferët të cilët zhvillojnë gara shpejtësie në trafikun rrugor. Me qëllim të sensibilizimit të

shoferëve të automjeteve, në kuadër të kësaj fushate janë duke u shpërndarë fletushka me moton "Trafiku rrugor nuk është i destinuar për gara shpejtësie". Krahas shpërndarjes së fletushkave, policia në vazhdimësi po informon drejtuesit e mjeteve për pasojat dhe masat ndëshkimore që parashihen me dispozitat e Ligjit

për Rregullat në Trafik, ku ndaj kundërvajtësve, parashihet gjobë prej pesëqind (500) eurosh, pesë (5) pikë negative, si dhe masa mbrojtëse marrja e patentë shoferit për një (1) vit brenda vendbanimit, ndërsa jashtë vendbanimit parashihet gjoba prej katërqind (400) eurosh, katër (4) pikë negative, marrja e patentë shoferit për dhjetë (10) muaj.



## Filloi dezinfektimi i zonave endemike në Malishevë kundër rriqrave



MALISHEVË, 22 MAJ - Në kuadër të zbatimit të strategjisë nacionale për parandalimin dhe luftimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo (EHKK), komuna e Malishevës ka filluar dezinfektimin e zonave endemike, kundër rriqrave, si bartës të virusit të EHKK-së. Fillimin e kësaj fushate e ka parë nga afër edhe kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati dhe drejtorët e drejtorive përkatëse, përgjegjëse për realizimin e

dezinfektimit dhe zbatimit të masave parandaluese kundër EHKK-së. "Pavarësisht numrit të rasteve të thumbimeve nga rriqrat, është fat i mirë se tani e një dekadë nuk kemi raste të infektimit me këtë virus vdekjeprurës, por ne si komunë, brenda përgjegjësisë dhe kompetencave, jemi duke bërë të pamundurën për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve. Shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë që janë të angazhuar në luftimin dhe

parandalimin e kësaj sëmundje, duke filluar nga punëtorët shëndetësorë, zyrtarët përgjegjës komunalë, si dhe të gjithë qytetarët të cilët po tregohen shumë të kujdesshëm", ka thënë kryetari Kastrati me rastin e fillimit të dezinfektimit të zonave endemike. Po ashtu, kryetari Kastrati u ka bërë thirrje organeve përgjegjëse shtetërore, që t'i marrin masat e nevojshme për luftimin e EHKK-së.

## KEDS-i fuqizon arsimin me teknologji, duke dhuruar kompjuterë nëpër shkolla

PRISHTINË, 22 MAJ - Përveçse kompani e përgjegjshme për shpërndarjen e energjisë elektrike, KEDS-i vazhdon

misionin edhe duke mbështetur kategori shoqërore përmes kontributeve domethënëse. Në kuadër të Përgjegjësisë

Shoqërore të Korporatës, me qëllim të avancimit dhe edukimit të brezave të rinj, së fundi KEDS-i ka dhuruar

dhjetëra kompjuterë në shkollat fillore në rajonin e Mitrovicës, "Jashar Begu", "Xhevat Jusufi" dhe "Dëshmorët e Kaçandollit".





## Kandiçi: Askush për sulmin në Banjskë nuk është arrestuar, pse po heshtet për këtë rast?

PRISHTINË, 22 MAJ - Themeluesja e Fondit për të Drejtën Humanitare, aktivistja Natasha Kandiq, ka thënë se Serbia nuk ka asnjë arsye të mos e pranojë Rezolutën për genocidin në Srebrenicë. Ajo në një intervistë për "Radio Dukagjinin" ka bërë thirrje që të mos glorifikohen kriminelët, ndërkohë ka folur edhe për ndryshime vlerash rreth të drejtave të njeriut, duke përmendur luftën në Gaza e qëndrimin amerikan.

Kandiçi ka folur edhe rreth sulmit në Banjskë, për të cilin rast tha se ende askush në Beograd nuk është arrestuar. "Mendoj që Banjskën ende nuk e kemi sqaruar. Ajo duhet që në kuptimin juridik të zgjidhet. Do të thotë, duhet të ketë proces ndaj përgjegjësve. Askush lidhur me ngjarjen nuk është arrestuar. Nuk ka aktakuza. Jam e mendimit se derisa atje është KFOR-i nuk ka rrezik për aksione të ngjashme. Është dëshmuar se

ka kapacitete që me kohë të ketë informata dhe të pengohen incidente më të mëdha. Kështu që nuk pres se do të ketë përsëritje të Banjskës. Por, është e domosdoshme të zgjidhet çështja e Banjskës dhe nuk shoh pse po heshtet për këtë rast si nga pala kosovare, po ashtu edhe ajo serbe, por as bashkësia ndërkombëtare, në fakt, Bashkimi Evropian nuk po flet për këtë çështje", ka thënë ajo.



## AAK-ja akuzon qeverinë Kurti se nuk ka punuar për lehtësimin e votimit nga diaspora

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 MAJ - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e ka akuzuar qeverinë Kurti se nuk ka punuar në lehtësim të procesit të votimit nga diaspora, siç parashihet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në një konferencë për medie të mërkurën, shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, e ka cilësuar "skandal" situatën në këtë aspekt.

Ndonëse ky ligj ka hyrë në fuqi nëntë muaj më parë, Tahiri ka thënë se në vend të 50 centëve për votë, sërish diaspora duhet të paguajë nga 70-80 euro. "Votimi jashtë vendit për vëllezërit dhe motrat tona nga diaspora vazhdon të manipulohet duke e



penguar zbatimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili ka hyrë në fuqi në korrik të vitit të kaluar. Janë bërë nëntë muaj që kur ky ligj ka hyrë në fuqi e nuk

është ndërmarrë asnjë veprim për ta mundësuar votimin e vëllezërve dhe motrave tona sipas këtij ligji. Deri më tani nuk ka asnjë informatë dhe asnjë

marrëveshje ndërshtetërore për ta mundësuar votimin e qytetarëve të Kosovës në ambasada, siç thotë ligji. Ligji i ri kërkon që të krijohet një kuti

postare ku diaspora do të mund të votojë dhe pastaj këto vota që do të paguheshin me 50 centë të shkonin në atë kuti që do të ambalazhohej nga Ambasada e do të menaxhohej nga KQZ-ja në mënyrë që vota të vijë në Kosovë", ka thënë Tahiri.

Kritika ka adresuar edhe deputetja tjetër e AAK-së, Time Kadriaj, e cila ka thënë se është shqetësuese pasi Kurti e ka marrë votën e diasporës. "Për ne është shqetësuese sepse ka marrë votën e popullit. Ka marrë 90 mijë vota nga diaspora duke thënë që kemi për t'i mbajtur premtimet, qoftë për Ligjin për Diasporën dhe atë për rregullimin e votimit të diasporës. Mënyra e deritanishme e votimit është e komplikuar", ka thënë Kadriaj.

## AMMK-ja kërkon të ngrihet vetëdija për zonat e mbrojtura në Kosovë



PRISHTINË, 22 MAJ - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe Agjencia Suedeze për Mbrojtjen e Mjedisit kanë mbajtur punëtorinë me temën "Ndërtimi i kapaciteteve mjedisore mbi përdorimin e të dhënave në Kosovë".

Ngritja e kapaciteteve mjedisore mbi përdorimin e të dhënave në Kosovë, konkretisht komponenti i pestë synon ta ndihmojë Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) për ta përmirësuar menaxhimin e qëndrueshëm të parqeve kombëtare në Kosovë, është

thënë në këtë punëtori. Hanna Berggren nga Agjencia e Mjedisit të Suedisë ka thënë se objektivi kryesor ishte anëtarësimi i Kosovës në Bashkim Evropian (BE). "Vetëm duhet të themi që si objektivi kryesor ishte anëtarësimi i Kosovës në BE. Projekti do të lehtësojë një hyrje më të qetë në Bashkimin Evropian duke pasur parasysh kontekstin e acquis mjedisore të BE-së. ISO 1 synon ta mbështesë AKMM-në në menaxhimin dhe zhvillimin e metodave për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm të

përshtatshme për organizatën e AKMM-së", është shprehur Berggren.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri", Bajram Kafexholli, ka thënë se qëllimi i këtij projekti ka qenë ngritja e vetëdijes për zonat e mbrojtura të Kosovës, në veçanti për parqet kombëtare. Kurse Modestina Abrashi nga AMC-ja ka paraqitur statistikën nga "Meta Data" në "Facebook" për fushatat vetëdijesuese për parqet kombëtare ku "reach"-i ka arritur në 158 mijë.

## Konjufca pret në takim studentë nga Universiteti i Floridës

PRISHTINË, 22 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim studentë nga Universiteti Shtetëror i Floridës.

Në kuadër të programeve ndërkombëtare të këtij universiteti, që tashmë për herë të parë përfshin edhe Republikën e Kosovës si vend në listën e

partneritetit të universitetit, studentët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës vijnë në vendin tonë për ta njohur të shkuarën dhe aktualitetin nga spektri i të drejtave të njeriut. Kryetari Konjufca në bisedën me studentët e universitetit amerikan foli rreth historisë së Kosovës deri te shpallja e pavarësisë, për kulturën e vendit

tonë, çështjet aktuale dhe synimet e integritimit ndërkombëtar. Po ashtu, theksoi edhe kontributin e madh të ShBA-së në Kosovë dhe rëndësinë e saj të pazëvendësueshme. Kryetari Konjufca i falënderoi studentët për vizitën, duke u uruar atyre suksese përbrenda këtij programi universitar.





# Çfarë do të bëhet me paratë e marra nga institucionet serbe në veri?



PRISHTINË, 22 MAJ - Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar e Kosovës nuk ka ende vendim gjykatë për t'i administruar miliona eurot që Policia e Kosovës tha se i konfiskoi në disa institucione financiare në veri të vendit më 20 maj. "Pa e marrë një vendim nga gjykata, ne nuk mund të bëjmë asgjë. Ne veprojmë sipas vendimit të gjykatës kompetente", thotë shkurtimisht për "Radion Evropa e Lirë" zëvendësi i drejtorit të përgjithshëm të kësaj agjencie, Enver Krasniqi. Për këtë temë, "REL"-i kontaktoi edhe Ministrinë e Drejtësisë, në kuadër të së cilës funksionon Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar, por ajo nuk u përgjigj. Tash për tash nuk është e qartë se në kompetencë të cilës

gjykatë është çështja. Një ditë më herët Policia e Kosovës mbylli gjashtë objekte të institucioneve financiare të Serbisë në pjesën veriore të vendit, të banuar me shumicë serbe. Gjatë aksionit ajo tha se konfiskoi në total mbi 2.2 milionë euro - në mesin e tyre edhe dinarë, franga dhe dollarë amerikanë dhe australianë. Aksioni u zhvillua pak ditë pasi Banka Qendrore e Kosovës bëri me dije se periudha transitore për zbatimin e rregullores së saj, që e ndalon përdorimin e dinarit serb në Kosovë, ka skaduar. "Radio Evropa e Lirë" iu drejtua Policisë së Kosovës me pyetjet se ku janë paratë e marra nga institucionet financiare serbe në veri dhe a janë konfiskuar apo sekuestruar ato, por nuk mori përgjigje. Ajo sugjeroi vetëm që të merret për referencë komunikata e saj e datës 20 maj.

Konfiskimi nënkupton marrjen e përhershme të pasurisë me urdhër të prerë nga gjykata kompetente apo organi tjetër kompetent në pajtim me ligjin në fuqi, kurse sekuestrimi marrjen e pasurisë nga organi kompetent deri në vendimin e prerë të gjykatës.

## Çfarë tash?

"Në rastin konkret kemi të bëjmë me sekuestrim dhe jo konfiskim, që do të thotë ngrirje e përkohshme e këtyre mjeteve, derisa të përfundojnë të gjitha procedurat ligjore", thotë për Radion Evropa e Lirë, Gëzim Shala, hulumtues në Institutin e Kosovës për Drejtësi. Sipas tij, nëse vërtetohet se ato mjete kanë rrjedhur nga dukuri të kundërligjshme, atëherë "mund të merret vendimi për konfiskimin e tyre", që

nënkupton "marrjen përfundimtare të parave në pronësi të Republikës së Kosovës". Shala thotë se faza hetimore - derisa të merret vendimi përfundimtar i gjykatës kompetente - mund të zgjasë deri në tre vjet. Në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës thuhet, po ashtu, se pasuria e sekuestruar mbahet në mënyrë adekuate nga policia deri në nxjerrjen e urdhrat të gjykatës për ndalim.

## Kritika Kosovës

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) tha se është i zhgënjyer me aksionin e Policisë së Kosovës në institucionet financiare serbe në veri dhe, sipas tij, ai i përshkallëzon tensionet në zonën e banuar me shumicë serbe.

Bashkimi Evropian reagoi ngjashëm. "Operacionet e së hënës dëshmojnë edhe një herë se autoritetet e Kosovës u japin prioritet veprimeve të njëanshme dhe të pakoordinuara më shumë sesa bashkëpunimit me miqtë dhe aleatët në terren", tha zëdhënësi Peter Stano.

Në Serbi, ndërkaq, kryeministri Millosh Vuçeviq e cilësoi aksionin si "akt barbar" që, siç tha, "kërcënon drejtpërdrejt mbijetesën e popullit serb" në Kosovë.

Ish-ministri i Drejtësisë i Kosovës, Jonuz Salihu, pajtohet se çështja merr konotacion politik dhe dyshon se mund të zgjidhet përmes bazës ligjore të Kosovës. "Unë besoj se sekuestrimi i këtyre parave duhet të jetë objekt i bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e BE-së", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Javën e kaluar, kryenegociatori i Kosovës dhe ai Serbisë përfunduan pa sukses raundin e shtatë të bisedimeve për çështjen e përdorimit të dinarit serb në Kosovë.

Rregullorja e BQK-së që e ndalon dinarin, duke e bërë euron mjet të vetëm pagese me para të gatshme, hyri në fuqi më 1 shkurt, ndërsa më 13 maj BQK-ja tha se periudha transitore për zbatimin e saj ka përfunduar. Rregullorja i rriti fërkimet në mes të Kosovës dhe partnerëve të saj përëndimorë, të cilët kërkuar pezullimin e saj derisa komuniteti serb, i cili prej vitesh pranon pagesa të ndryshme në dinarë nga Serbia, të përshtatet me praktikën e re.

Autoritetet e Kosovës, megjithatë, nuk u zbrapsën. Policia tha se qëllim i aksionit të saj në veri, më 20 maj, ishte "vendosja e rendit dhe ligjshmërisë".

Nga 1 shkurti edhe Dogana e Kosovës njoftoi disa herë se ka ndaluar hyrjen e dinarëve nga Serbia në Kosovë, me arsyetimin se nuk e ka miratimin e BQK-së. Së paku deri më 17 maj, sipas raportimeve të "REL"-it nga terreni, pagesat në mjediset me shumicë serbe në Kosovë kanë vazhduar të bëhen edhe në euro, edhe në dinarë.

## Rafuna për aksionin në veri ndaj bankës serbe: Kosova të koordinohet me aleatët

Prishtinë, 22 maj - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, në lidhje me aksionin e Policisë së Kosovës në veri kundër institucioneve financiare serbe në Kosovë, më 20 maj, ku u konfiskuan mbi 2.2 milionë euro, ka thënë se tashmë janë duke vazhduar hetimet derisa të konstatohet se çfarë do të bëhet me ato para. Në

emisionin "Magazina" në Radio Dukagjini, në lidhje me këtë aksion e të tjera të tilla ka kërkuar nga Kosova të ketë koordinim me vendet aleate. "Me sa kam pasur mundësi të kem informacion prej medieve, në këtë aksion ka qenë e aktivizuar edhe Administrata Tatimore e Kosovës me policinë. Besoj se pritet proces hetimi se çka do të bëhet tutje me paratë.

Paratë nuk mund t'u kthehen qytetarëve nga policia e ATK-ja. Do të merret një vendim se çka do të bëhet tutje me çështjen e parave. Janë të sekuestruara derisa të konstatohet a janë të ligjshme apo të paligjshme. Kosova duhet të bashkërendohet me ShBA-në e vendet e QUINT-it, me vendet aleate", ka deklaruar Rafuna.





# Robert Fico, populist dhe përçarës: lideri pro-rus që u ka rezistuar skandaleve dhe humbjeve

*Ai dha dorëheqjen pas vrasjes së gazetarit Kuciak. Shtatorin e kaluar fitoi sfidën për mandatin e tij të katërt me tone pro-ruse dhe ksenofobe*



Eshtë në anën e Viktor Orbanit, lideri më përçarës evropian, Robert Fico. Tani, në momentin e dobësisë maksimale, teksa po lufton mes jetës dhe vdekjes, kush e di nëse historia e tij do të jetë në gjendje të shkaktojë një rënie të tensionit midis fronteve kundërshtarë – pro-ruse dhe pro-perëndimore, populiste dhe progresive – që shkon përtej deklaratave të rastit, për dënimin e dhunës dhe klimës së urrejtjes.

Shëmbëlltyra politike e Ficos ka pasur më shumë kthesa: si lider ai u konsiderua i mbaruar pesë vjet më parë, me mijëra njerëz në rrugë që kërkonin (dhe merrnin) dorëheqjen e tij, pas vrasjes së gazetarit investigativ Ján Kuciak dhe të dashurës së tij. Ai dukej i dënuar: partia e tij social-populiste, e përçarë dhe duke rrëshqitur drejt

minimumit, kishte dështuar të fitonte zgjedhjet e vitit 2020, për herë të parë që nga viti 2006. Por, ajo u kthye në modë: shtatorin e kaluar ai fitoi sfidën për mandatin e tij të katërt me tone haptazi pro-ruse dhe ksenofobe, dhe që atëherë ka qeverisur një koalicion populistësh të majtë dhe ultranacionalistësh. Si një pro-evropian, ai kohët e fundit është treguar kundër dërgimit të armëve në Ukrainë dhe hyrjes së saj në NATO. Shoqëria sllovaqe e ka gjetur veten më të ndarë se kurrë.

“Në realitet, që në kohën e protestave për Kuciakun, vendi u nda në dy grupe të mëdha: ata që besojnë në demokracinë liberale, lirinë dhe institucionet demokratike dolën në rrugë për të kërkuar një klasë të re politike, ndërsa mbetën në

shtëpi fansat e të fortit, që Kuciakun e konsideron vetëm një dështim të sistemit, një problem personal të Ficos dhe jo për vendin”, thotë Peter Bárdy, drejtor i Aktuality dhe autor i “Fico – I fiksuar pas pushtetit”.

Është historia e politikanit më me ndikim dhe më kontrovers në historinë moderne të Sllovakisë: ai u bë deputet në moshën njëzet e tetë vjeçare në vitin 1992, në radhët e partisë së majtë të lindur nga hiri i partisë komuniste, më pas themeloi Smer, një parti socialdemokrate që aderon në grupin S&D në Bruksel (duke turpëruar socialistët e Evropës). Ai u zgjodh kryeministër tre herë në vitin 2006, 2012 dhe 2016. Mandati i fundit u ndërpre nën presionin e rrugëve dhe gjykatësve.

Arsyet e rilindjes së tij janë pjesë e shëmbëlltyrës së tij të guximshme politike: nga një komunist i epokës sovjetike, tek populist i sotëm që kërkon aleanca në të djathtën ekstreme. “Në realitet, Fico nuk ka ndryshuar kurrë, ai ka qenë gjithmonë një njeri pragmatik, cinik, i etur për pushtet – thotë Bárdy –. Ai është një njeri me një mijë fytyra, një për çdo rast. Në të kaluarën ai u tregua pro-evropian, dhe një minutë më pas, anti evropian.

Pas pushtimit të Krimesë, në vitin 2014, për shembull, ministri i tij i Jashtëm votoi në Bruksel në favor të sanksioneve kundër Rusisë, ndërsa në Sllovakia përsëriti se sanksionet nuk funksionojnë: «Ai ka treguar dyfytërsi gjatë gjithë karrierës së tij. Ishte strategjia e tij cinike për të qëndruar në pushtet”.

Muajt e fundit – sipas disave – Fico ishte akoma më pak i shqetësuar se duhej të shfaqej pajtues në sytë e Perëndimit: për këtë arsye ai theksoi tonet më të ashpra. “Pas vrasjes së Kuciak, e kishte të qartë se votuesit e tij nuk janë liberalë, socialdemokratë, por të zemëruarit antisistem, dhe tani në qeveri është bërë një Orbán i vogël”.

Muajin e kaluar reforma e tij në radion dhe televizionin publik bëri bujë, e kundërshtuar gjithashtu nga Reporterët pa Kufij si një përpjekje për të penguar median publike. Nën presionin e Brukselit dhe rrugës, qeveria e tij u detyrua të tërhiqej nga propozimet e saj të diskutueshme për të reformuar kodin penal. / bota.al



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT  
 PILKINGTON Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



## Ademi dhe Foda diskutojnë për kampin e qershorit dhe Ligën e Kombeve

**PRISHTINË, 22 MAJ** - Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, priti të mërkurën në takim përzgjedhësin e Kosovës, Franco Foda, me bashkëpunëtorë. Gjatë këtij takimi u diskutua gjerësisht për kampin e ardhshëm të ekipit përfaqësues, i cili do të zhvillohet në muajin qershor, si

dhe për përgatitjet sa më të mira për edicionin e radhës të Ligës së Kombeve që nis në shtator. Në këtë takim, presidenti Ademi shprehu mbështetjen e plotë për trajnerin Foda dhe shtabin e tij teknik. Ai theksoi rëndësinë e përgatitjes sa më të mirë për kampin e qershorit, duke e konsideruar atë një mundësi të

mirë për ta konsoliduar ekipin për ndeshjet e Ligës së Kombeve. Presidenti Ademi vuri në dukje se 2024-ta është një vit shumë i rëndësishëm për ekipin përfaqësues të Kosovës, duke kërkuar nga trajneri Foda dhe lojtarët ta japin maksimumin e tyre për t'i arritur rezultatet e kërkuara. Ai shprehu besimin se

me një punë të përbashkët dhe një përkushtim të plotë, ekipi mund t'i realizojë objektivat e vendosura dhe t'i bëjë krenarë "Dardanët". Nga ana e tij, trajneri Franco Foda falënderoi presidentin Ademi për mbështetjen dhe besimin e treguar, duke theksuar se ai dhe ekipi i tij janë të përkushtuar për



ta arritur suksesin dhe për të bërë më të mirën me Përfaqësuesen e Kosovës.

# Ballkani, fitues i Kupës së Kosovës

### "Epoka e re"

**DRENAS, 22 MAJ** - FC Ballkani ka triumfuar në finalen dramatike të Kupës së Kosovës në futboll, duke mposhtur FC Prishtinën, pas serisë së penalltive, me rezultat 4:2. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas përfundoi me rezultat të barabartë 2:2 pas kohës së rregullt dhe vazhdimeve. Ballkani e nisi fuqishëm ndeshjen, duke shënuar golin e parë në minutën e 21-të përmes Walid Hamidit. Meriton Korenica dyfishoi epërsinë në minutën e 52-të, duke e vënë Ballkanin në një pozicion të favorshëm. Megjithatë, FC Prishtina nuk u dorëzua dhe Albin Krasniqi arriti të barazojë shifrat me dy gola brenda katër minutave. Krasniqi shënoi golin e parë nga penalltia në minutën e 78-të dhe pastaj barazoi në minutën e 82-të, duke e çuar ndeshjen në vazhdime. Në këtë periudhë të lojës të dyja ekipet luftuan fort, por nuk arritën të shënojnë golin e fitores, duke e çuar ndeshjen në penallti. Në serinë e penalltive, Albin Krasniqi, i cili ishte heroi në kohën e rregullt, u bë tragjik, pasi gjuajtjen e tij e priti portieri Enea Koliqi. Ardian Muja gjithashtu ishte i pasaktë, duke goditur traversën dhe kështu i dha mundësi Ballkanit



për festë. Kështu, Ballkani u kurorëzua për herë të parë me Kupën e Kosovës në histori të klubit, duke e mbyllur edicionin me kurorën e dyfishtë, pasi fundjavën e kaluar e siguroi edhe titullin e kampionit në AlbiMall Superligë. Në anën tjetër, FC Prishtina mbeti pa

dalje në Evropë, pasi fitorja e portokallezinjve ia mundëson një gjë të tillë Malishevës. Medaljet për dy ekipet fituese i ndanë nënkryetarët e FFK-së, Bakir Burri dhe Agim Dibrani, derisa trofeun për kapitenin e Ballkanit, Edvin Kuç, e ndau presidenti Agim Ademi.

## Sonte vendoset kampioni i ri në Superligë

**MITROVICË, 22 MAJ** - Pas një rrugëtimi të gjatë, ky edicion do të përfundojë të enjten mbrëma në Mitrovicë. Trepça dhe Golden Eagle Ylli do të ndeshen në sfidën vendimtare, ku kush fiton do të shpallet kampion i Kosovës. Seria finale është 2:2, që ishte shumë interesante, kurse interesimi për finalen e pestë të "play-off"-it është i jashtëzakonshëm. "Xehetarët" fituan 77:68 dhe 85:78, derisa therandasit fituan 80:79 dhe 75:71. Mitrovicasit duan titullin e pestë në histori të klubit, apo të parin që nga viti 2012, kurse therandasit të tretin, ku më 2021 dhe 2022 ishin shpallur kampionë të Kosovës. "Xehetarët" synojnë trofeun e katërt këtë edicion,

pasi kanë fituar Kupën, Superkupën dhe Ligën Unike. Trepça në gjysmëfinale eliminoi Sigal Prishtinën 3:0, derisa Golden Eagle Ylli, në çerekfinale munda Bashkimin 2:0 dhe Pejën në gjysmëfinale 3:2. Mitrovicasit në edicionin e rregullt përfunduan në vendin e parë me 25 fitore e tri humbje, kurse therandasit në vendin e tretë me pikë të barabarta me Pejën që ishte e dyta me 19 fitore e nëntë humbje. Në garat e rregullta të elitës, të dy skuadrat kishin nga dy fitore ndaj njëra-tjetrës, derisa mitrovicasit triumfuan edhe në Ligën Unike ndaj therandasve dhe në gjysmëfinale të Kupës. Ndeshja zhvillohet të enjten në Mitrovicë nga ora 19:00.



## Kuka: Xhudo po e shkruan historinë e Kosovës

**PEJË, 22 MAJ** - Xhudo vazhdon ta bëjë krenare Kosovën me sukseset e jashtëzakonshme. Laura Fazliu e fitoi të martën medaljen e bronzit në Kampionatin Botëror të Xhudos, i cili po mbahet në Abu Dhabi. Për garuesen tonë kjo ishte medalja e parë në një

garë aq prestigjioze, kurse Kosova me këtë rast e siguroi medaljen e tetë të Kampionateve Botërore. Këto suksese po e bëjnë krenar trajnerin Driton Kuka. "Për një ditë të mirë. Xhudo po e shkruan historinë e Kosovës. S'po e them unë, por Federata

Evropiane e Xhudos! Laura është sportistja e pestë që po prek majat botërore nga sporti i xhudos kosovare!", ka shkruar Kuka, i cili e shpërnda një postim të Federatës Evropiane të Xhudos, e cila ia kushtoi këtë postim Laura Fazliut.





## Xhevdet Muriqi viziton FFK-në, pritet nga presidenti Ademi

PRISHTINË, 22 MAJ - Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, priti në takim ish-futbollistin e gjeneratës së artë të FC Prishtina, Xhevdet Muriqi. Në këtë takim të përzemërt u

diskutua për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e futbollit të Kosovës. Gjatë takimit, presidenti Ademi shprehu mirënjohjen e tij ndaj kontributit të ndritur të Xhevdet

Muriqit në fushën e futbollit dhe për rolin e tij në zhvillimin e këtij sporti në Kosovë. Xhevdet Muriqi, nga ana e tij, falënderoi presidentin Ademi për pritjen dhe për interesimin e tij të

vazhdueshëm për gjeneratat e kaluara të futbollit. Ai, po ashtu, përgëzoi kreun e FFK-së për punën e mirë në përparimin e futbollit në vend në të gjitha aspektet.



## Presidenti Ademi priti Këshillin Organizativ të turneut madhështor 'Kenan Halimi'

PRISHTINË, 22 MAJ - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka mirëpritur me kënaqësi në zyrën e tij Këshillin Organizativ të Turneut Tradicional në Futboll të Vogël "Kenan Halimi" nga fshati Gjylekar në komunën e Vitisë. Ky turne, i cili organizohet në nderim të dëshmorit të kombit Kenan Halimi, është një ngjarje e rëndësishme në kalendarin e futbollit të Kosovës dhe një prej turneve më të mëdhenj në vend. Edicioni i 10-të i këtij turneu do të sjellë sërish valë emocionesh dhe pasion për futbollin nga ekipet pjesëmarrëse nga të gjitha trojet shqiptare.

Pamjet e mijëra shikuesve që mbushin fushën e futbollit ku zhvillohet ky turne tregojnë më së miri për nivelin e organizimit dhe pasionin e madh të banorëve të kësaj treve për futbollin. Në këtë



kontekst, presidenti Ademi ka shprehur vlerësimin e tij për organizatorët dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në suksesin e këtij turneu ndër vite. Presidenti Ademi theksoi se ky turne promovon trashëgiminë sportive, njëherësh

kujtesën për dëshmorët e kombit. Ai ka thënë se FFK-ja është e vendosur të vazhdojë të mbështesë dhe të promovojë ngjarje të tilla, që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin dhe promovimin e futbollit në Kosovë.

## Verstappeni: Rivalët i kemi afër, nuk mund të bëjmë më asnjë gabim

IMOLA, 22 MAJ - Max Verstappeni fitoi garën e fundit të Formulës 1 të zhvilluar në pistën e Imolas, por për kampionin e botës nuk ishte një triumf i lehtë. Përkundrazi. Një garë ndryshe nga zakonisht për holandezin, që në fund rrezikoi ta humbiste kreun. "Kam qenë nën presion gjatë gjithë garës. Kam shtyrë fort për të krijuar një avantazh. Me gomat e mesme ishim të fortë, por ishte për t'u menaxhuar, veçanërisht në fundin e garës", u shpreh tri herë kampioni i botës me Red Bull. "Pashë Norrisin që po afrohej. Në xhirot e fundit shtyva në maksimum, por gomat nuk funksionuan. Ne nuk mund të përballonim asnjë gabim, por jam i lumtur me atë fitore, pasi na jep shtysë për garën e ardhshme në Monaco", ka thënë Verstappeni. "Ne kemi ndryshuar shumë në makinë.



Ndoshta kjo është arsyeja pse kemi pasur vështirësi. Por, bazuar në atë se si përfunduan gjërat, jam i lumtur. Tani

kuptojmë se diferencat me rivalët janë të vogla dhe s'lejohe më gabime", ka shtuar piloti holandez.

## Bostoni mposhti Indianan pas kohës shtesë

Kanë startuar seritë e ndeshjeve finale në NBA. Boston Celtics i nis me këmbën e mbarë finalen "play-off"-it në Konferencën e Lindjes, duke mundur në fushën e tij 133-128 Indianan, takim i

vendosur pas kohës shtesë. Një përballje mjaft e bukur, ku të dyja ekipet meritonin fitoren. Të gjithë titullarët e ekipit të Bostonit realizuan mbi 15 pikë, ku më i miri ishte Jayson Tatum,

autor i 36 pikëve dhe 12 reboundeve. Mirë u paraqitën edhe Holiday me 28 pikë e Browni me 26 pikë, një treshe që u tregua e saktë në çastet vendimtare. Për Indianan, shtatë

lojtarë realizuan mbi 10 pikë, një lojë e mirë kolektive, por që në fund nuk i mori frutet e pritura. Haliburtoni me 25 pikë e 10 asistime ishte shënuesi më i mirë për miqtë, por që nuk mjaftuan

për të fituar. Edhe ndeshja e dytë finale e Lindjes do të luhet në fushën e Bostonit, skuadër që bëri shumë mirë gjatë sezonit të rregullt dhe po e tregon formën e mirë edhe në finale.

### SHKURT

#### Ronaldo reagon pas lamtumirës së Kroosit: Nder ta ndaja fushën me ju

Cristiano Ronaldo është mes futbollistëve të shumtë që kanë reaguar ndaj vendimit të Toni Kroosit për t'u tërhequr nga futbollit pas "Euro 2024". "Për gjithçka dhe për kaq shumë, Toni! Çfarë nderi që kam ndarë fushën me ju. Gjithë të mirat për të ardhmen", ka shkruar Ronaldo në postimin e Kroosit në "Instagram". Të dy lojtarët ndan dhomën e zhveshjes të Reali i Madridit për katër sezona, duke fituar së bashku një titull të La Ligas dhe tre të Ligës së Kampionëve. Duhet theksuar se Toni Kroos ka rezervuar gjithmonë fjalë komplimentuese për Cristiano Ronaldon, duke këmbëngulur se ai ishte lojtari më i mirë me të cilin ka luajtur në karrierën e tij.

#### Mbappe nuk lejohet të shkojë në Olimpiadë

Kylian Mbappë nuk do të marrë pjesë në turneun olimpiq të futbollit me përfaqësuesen e Francës, të udhëhequr nga Thierry Henry. Shpresa për ta parë sulmuesin e famshëm në eventin më të madh sportiv të vitit është shuar përfundimisht. Henry bëri gjithçka për ta pasur nën urdhrat e tij Mbappen, madje kërkoi edhe ndihmën e presidentit të vendit Emmanuel Macron (ndërhyri personalisht te Florentino Perez), por ka qenë e kotë. Sipas asaj që raporton "Cadena Cope", diskutimet tani janë ndërprerë midis FFF dhe klubit "merengues". Në fakt, nuk ka pothuajse asnjë shans që Mbappe t'i forcojë "Gjelat" në këtë ngjarje të madhe. Reali nuk e ka zakon t'i lejojë lojtarët e tij të huaj të largohen për në Lojërat Olimpikë dhe nuk ka ndër mend të bëjë përjashtim. Për futbollistët spanjollë sigurisht që është një histori tjetër, sepse rregulloret lokale e detyrojnë të mos bëhet pengesë për "La Rojan". Për Mbappenë, duhet të jetë një zhgënjim që nuk do të jetë i pranishëm në Paris 2024. Ai ka thënë gjithmonë se do t'i nënshtrohej vendimit të klubit, cilido qoftë ai. Dhe është e sigurt se ai nuk do të dalë kundër zgjedhjes së drejtuesve të Realit.

#### Allister shihet si zëvendësues i Kroosit në Real

Real Madridi është në kërkim të një zëvendësuesi pasi Toni Kroos do të largohet në fundin e këtij sezoni. Skuadra madrilene po ndjek me interes mesfushorin e Liverpoolit, Alexis Mac Allister, i cili mund të jetë një zëvendësues ideal për Kroosin. Siç raporton "The Sun", raportet në Argjentinë kanë pohuar se kontaktet mes Liverpoolit dhe Madridit kanë filluar, por asnjë ofertë nuk është bërë deri tani. Mac Allister iu bashkua Liverpoolit verën e kaluar si pjesë e një ndryshimi të madh në mesfushë dhe ka shkëlqyer nën drejtimin e Jurgen Kloppit. Gjithsesi ai është vetëm dëshira e parë, pasi emra të tjerë pritet të qarkullojnë në ditët në vijim.

#### Chelsea konfirmon largimin e Pochettinos

Chelsea përmes një komunikate në faqen e klubit e ka bërë zyrtare se ka arritur marrëveshje të ndërsjellë me trajnerin Mauricio Pochettino për t'i ndarë rrugët në fund të këtij sezoni. Mauricio Pochettino nuk do të jetë trajneri i Chelseat nga sezoni i ardhshëm 2024/25. "Në emër të gjithëve në Chelsea, ne dëshirojmë ta shprehim mirënjohjen tonë për Mauricion për shërbimin e tij këtë sezon. Ai do të jetë i mirëpritur të kthehet në Stamford Bridge në çdo kohë dhe ne i urojmë të gjitha të mirat në karrierën e tij të ardhshme si trajner", kanë thënë drejtorët sportivë të klubit, Laurence Stewart dhe Paul Winstanley.





**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria – Vlada - Government

**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**  
 Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
 Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**  
 për **Kushtet Ndërtimore**

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 2317/23 të datës 03.05.2023, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomandë:**  
 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
 Ndërtesa e Rilindjes  
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmp-h-rs.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
 Telefon: + 381 38 200 32 222



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
 Sallon Depilimi Lume's Details  
 lumesdetails  
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Markeleon” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810176265.
- Xhafer Shala shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike “Hasan Tasini” ish shkolla “Nikolla Tesla” Obiliq.
- Blerina Lluhani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Valmira Krasniqi nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I-VII tw SH.F.M.U. “Kongresi Manastirit” Damjan KK Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales







**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

